



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 Nr. 470/04-21452/18
Kaçanik, 17.07.2018

Në bazë të nenit 12.2(d) të Ligjit- Për Vetëqeverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/ 04 Qershor 2008) të nenit 58 të Rregullores për Punë të Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 17 Korrik 2018, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
NGA TË GJETURAT E AUDITORIT PËR PVF 2017

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Veprimit 01 Nr. 470/04-21452/18 -Për zbatimin e Rekomandimeve nga të gjeturat e Auditorit për PVF, 2017, i propozuar nga Kryetari i Komunës prej datës 06.07.2018.

2. Në Planin e Veprimit si në pikën 1 të këtij Vendimi, janë paraqitur; veprimet të cilat do t'i merr Kryetari i Komunës dhe zyrtarët tjerë përgjegjës për zbatimin e Rekomandimeve dhe afati kohor për të gjeturat e Auditorit për PVF 2017 dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

3. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e dërgimit të aktit në MAPL respektivisht 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Kryetari i Komunës dhe zyrtarët tjerë përgjegjës të përcaktuar si në Planin e Veprimit 01 Nr.470/04-21452/18 - Për zbatimin e Rekomandimeve nga të gjeturat e Auditorit për PVF, 2017.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës/ përmes Zyrës së Kryetarit, njoftohen zyrtarët përgjegjës –zbatues të Planit të Veprimit,
2. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe
3. Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Zyra e Kryetarit

01 Nr. 470/04-2165/18
Kaçanik; 06.07.2018

PËR/ZA/TO:	ZYREN E KUVENDIT KOMUNAL – KRYESUESIT Z. KEMAJL MËRSELI
NGA/OD/FROM:	Besim Ilazi – Kryetar Komune-ZKA
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Dorëzimi i Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar 2017



Të nderuar,

Bashkëngjitur me këtë shkresë po iu dergojmë Planin e Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31.12.2017 për shqyrtim dhe diskutim në seancën e ardhshme e cila do të zhvillohet nga Asambleja Komunale.

Me respekt;

Plani i Veprimt për zbatimin e Rekomandimeve nga të gjeturat e Auditorit në

PFV' 2017



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kacanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Zyra e Kryetarit

Të gjeturat/ gëshjtjet	Rekomandimet	Aktivitetet e pritura	Datat e përcaktuara	Bartësit / Drejtoritë përkatëse
Çështja 1 - Theksim i qështjes: E gjetura: Shpalosjet e pasurive kapitale në pasqyrat financiare vjetore nuk ishin plotësisht të sakta, për shkak të mos përfshirjes së investimeve	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, si dhe të merren veprimet e duhura për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe për ta konfirmuar regjistrimin e	Komisioni i themeluar enkas per këtë qëllim në përbërje nga një anëtar prej secilit institucion financuaes (K.Kaçanik, M.e Shëndetësisë dhe Fondacioni Kosovo Luxemburg) do ti ndërmerr gjitha hapat e	Mars - Shtator 2018	Komisioni i themeluar i cili është përgjegjës për sigurimin e pranimt teknik të objektit të QKMF-së. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

<p>kapitale në vlerë 350,000€, për ndërtimin e objektit të QKMF-së në bashkëfinancim me Caritas Luksenburg dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Kjo ka ardhur për faktin se Komuna nuk kishte marrë dokumentacion mbështetës nga bashkëfinancuesit, për pjesën që ata e kishin financuar. Kjo reflekton pasaktësi në regjistrat e pasurisë dhe shpalosje jo të saktë tyre në PFV-të e vitit 2017.</p>	<p>plotë të pasurisë kapitale. E gjithë pasuria, përfshirë pronat të cilat i posedojnë si dhe pasuritë jo financiare të blera/ndërtuara duhet të regjistrohen në regjistrat e pasurisë.</p>	<p>nevojshëm per sigurimin e pranimit teknik te objektit te QKMF-së. Do të shtohet kordinimi me Ministrinë e Shëndetësisë në mënyrë që anëtarit i këtij komisioni i cili perfaqeson Ministrinë perkatese te bashkëpunoj ngushtë me anëtarët tjerë të këtij komisioni dhe te arrijnë ta përfundojnë procesin e Pranimit Teknik për objektin e QKMF-së.</p>	<p>Zyra e Kryetarit</p>	
<p>Çështja 2 – Realizimi i ulët i buxhetit për investime kapitale</p> <p>E gjetura: Komuna nuk kishte arritur të realizoj</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj se është ndërmarrë një vlerësim sistematik i shkaqeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimeve kapitale dhe të përcaktojë</p>	<p>Pas sigurimit te raportit mbi pranimin teknik te objektit te ri te QKMF-së, komisioni perkates I dergon nje kopje zyrtarit te regjistrimit te pasurisë jofinanciare tek sektori I financave dhe bëhet regjistrimi i tij në FREE-BALANCE.</p> <p>Menaxhimi i projekteve kapitale vazhdon të mbetet fusha më me prioritet nga organet komunale, ngase permes kesaj kategorie ekonomike mvaret</p>	<p>Prill - Dhjetor 2018</p>	<p>Drejtorja e Sherbimeve Publike dhe Emergjencave, Drejtorja e Urbanizmit, Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor.</p>

<p>buxhetin për investime kapitale sipas planit dhe projekteve të synuara.</p> <p>Nga projektet të parapara me Programin për Investime Publike, 17 prej tyre në vlerë 97,000€, nuk kishin filluar së zbatuari. Kjo ka shkaktuar një ulje të performancës ndaj shpenzimeve në total.</p> <p>Githashtu shkaktare të ekzekutimit të ulët janë edhe vonesat në realizim të kontratave, që ndërthuret kryesisht me dinamikën e realizimit të projekteve nga operatorët ekonomik.</p>	<p>opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në vitin e ardhshëm.</p>	<p>shumë edhe cilësia e shërbimeve të ofruara ndaj qytetarëve.</p> <p>Një numër i konsideruar i projekteve kapitale të parrealizuara kanë të bëjnë me ekzistencën e tyre vetem si kode të planifikimit në listën e projekteve, mosrealizimi i tyre vjen si shkak i mos alokimit të te hyrave vetanake nga mospermbushja e planit prej 100% e inkasimit vijtor, ndersa pjesa tjetër ka të bëjë me ato projekte të cilat nuk kanë mundur të realizohen prej shkaqeve atmosferike etj. Komuna do të ndermerr hapat e nevojshëm siq janë rritja e nivelit të mbikqyrjes së projekteve, alokimi me kohë i fondëve, pershpëjtim i procedurave të prokurimit, etj.</p>		<p>Menaxherët - mbikqyrësit e projekteve,</p> <p>Drejtoritë tjera të cilat realizojnë projekte kapitale.</p>
<p>Çështja 3 - Verifikimi i pronave të regjistruara</p> <p>E gjetura: Komuna nuk</p>	<p>Kryetari duhet të përmirësoj procesin e verifikimit të pronave dhe të siguroj se verifikimi i 1/3-ës së tyre</p>	<p>Plani për rianketim dhe verifikim është hartuar dhe ka filluar të zbatohet me fillim të vitit fiscal 2018.</p>	<p>Prill - Dhjetor 2018</p>	<p>Drejtoria DEFZH përmes Zyrës së Tatimit në Pronë.</p>

<p>kishte arritur të kryej ri-anketimin për verifikimin e 1/3 e pronave të regjistruara, siç kërkohet me ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ në fuqi. Nga 8,847 prona të regjistruara vetëm 1,535 prona janë verifikuar. Komuna nuk kishte arritur të plotësoj këtë kërkesë ligjore (bazën me të dhëna të nevojshme), si pasojë e mungesës të zyrtarëve anketues në terren për grumbullimin e informatave.</p>	<p>bëhet në baza të rregullta vjetore, për të reflektuar gjendjen reale të pronave të tatuara. Rriçja e regjistrimit të pronave do të rezultojë me më shumë të hyra komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.</p>	<p>Sipas planit është paraparë që të verifikohen gjithësej 3010 prona për vitin 2018 apo 1/3 e gjitha pronave të regjistruara, siç kërkohet me ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ në fuqi.</p>		
<p>Çështja 4 – Nivel i ulët i inkasimit të të hyrave nga qiradhënia e pronave publike. E gjetura: Komuna ka dhënë me qira pronat komunale për shfrytëzim të përkohshëm, mirëpo niveli i inkasimit të tyre ishte shumë i ulët. Nga të hyrat e planifikuara nga shfrytëzimi i pronës publike në shumë prej 30,000€, ishin inkasuar vetëm 16,159€ apo 54%. Nga testimi i pesë</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një rishikim i dosjeve të qiramarrësve, kryesisht me qiramarrësit me të cilëve ju kanë vazhduar kontratat pa i kryer obligimet paraprake, dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme të inkasoj të gjitha obligimet e prapambetura. Gjithashtu, të krijoj dhe mbaj një evidencë të qartë dhe të kompletëj</p>	<p>Do të merren gjitha masat e duhura që inkasimi për shfrytëzimin e pronës komunale të realizohet më për së afërmi me planifikimet, kjo do të arrihet me leshimin e verejftëve tek shfrytëzuesit e këtyre pronave në fillim të vitit dhe të njëjve nuk do t'iu vazhdohet leja e shfrytëzimit pa i kryer obligimet paraprake. Bazur në kartelat e</p>	<p>Janar – Dhjetor 2018</p>	<p>Drejtorja e Urbanizmit, Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor.</p>

<p>shfrytëzueseve, kemi gjetur se komuna kishte vazhduar kontratat me qiramarrësit e pronës publike, edhe pse qiramarrësit nuk kishin kryer obligimet paraprake në shumë prej 24,899€.</p>	<p>atë me të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që menaxhimi i të hyrave nga qiraja të jetë më efikas.</p>	<p>borgjimjëve, do të iniciohen procedurat përbarimore të cilat lejohen me ligj, permes të cilave do të arrihet të përmiresohet dukshem bilanci i realizimit të të hyrave nga qeraja publike.</p>		<p>Drejtoria e Urbanizmit, Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor</p>
<p>Çështja 5 - Të hyrat nga lejet e ndërtimit</p> <p>E gjetura: Në bazë të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 21, pika 3, është paraparë që aplikuesit i lëshohet leja ndërtimore nëse ka paraqitur dëshmi për pagesën e taksës së lejes ndërtimore. Gjatë testimeve, ne kemi identifikuar se aplikuesit për leje të ndërtimit me nr. të protokollit: 06-352-7875/17 ju ka mundësuar pagesa me dy këste, me anë të një vendimi të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit në Komunë. Pas pagesës së kështit të l-re i njëjti ka marrë vendimin e lejes të ndërtimit, derisa kishte mbetur obligim për kështin e II-të në vlerë 3,904€.</p>	<p>Kryetari duhet të ndërmarrë veprimet për ta rishikuar vendimin për mundësinë e pagesave me këste, dhe të sigurojë se lejet e ndërtimit lëshohen vetëm pas përfundimit të pagesave të taksave në përputhje me legjislacionin për ndërtimet.</p>	<p>Drejtoria e Urbanizmit, Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor do të kujdeset që gjitha pagesat për leje ndërtimi gjatë vitit 2018 do të realizohen pa-këste mirepo me metodën 100% me rastin e aplikimit të gytetareve. Edhe pse aplikimi I pagesave me këste gjatë vitit të kaluar ishte kryer me qellim të ofrimit të lehtësirave për aplikuesit për leje ndërtimi.</p>	<p>Janar - Dhjetor 2018</p>	<p>Drejtoria e Urbanizmit, Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor</p>

<p>Çështja 6 – Mungesa e menaxherit të kontratës dhe personave te autorizuar</p>	<p>Kryetari duhet te siguroj se për secilin kontratë të nënshkruar, duhet të ekzistojë menaxheri i kontratës i cili monitoron në vazhdimësi realizimin e kontratës si dhe listën e personave të autorizuar të cilët do të bëjnë pranimin e mallrave dhe shërbimeve të kontraktuara.</p>	<p>Do te kete Menagjer te caktuar per Menagjimin e kontratave per furnizime.</p>	<p>Janar – Dhjetor 2018</p>	<p>Zyra e Prokurimit</p>
<p>E gjetura: Komuna nuk ka aritur të zbatoj udhëzimet e prokurimit për shkak të mungesës së mbikëqytjes efektive menaxheriale. Autoriteti Kontraktues në kontratën bazë nr. 16-7045/2016, tek pjesa e III e kontratës – kushtet e veçanta për furnizim me karburante për vetura, nuk ka caktuar menaxher të kontratës dhe persona të autorizuar për pranimin e furnizimeve.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se për secilin pagesë, për të angazhuarit përmes shërbimeve të veçanta, mbanë tatimin në burim dhe kontributet në përputhje me kornizën ligjore për tatimin në të ardhurat e personale.</p>	<p>Gjatë vitit 2018 do të fillohet me zbatimin e obligimeve që dalin nga Ligji për të ardhurat personale nr. 05-L-028.</p> <p>DEFFZH në kordinim me zyrën e Personelit do të krijojë listat e personelit te angazhuar permes Marrëveshjeve për</p>	<p>Janar – Dhjetor 2018</p>	<p>Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim Zyra e Personelit</p>
<p>Çështja 7 – Mos ndalja e tatimit në burim dhe kontributeve pensionale</p> <p>E gjetura: Gjatë vitit 2017, Komuna kishte angazhuar punonjës me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta. Në bazë të Ligjit për të ardhurat personale nr. 05-L-028, kërkohet që</p>				

<p>punëdhënësi të mbajë tatin në burim, për të ardhurat, përfshirë edhe për të angazhuarit përmes marrëveshjeve të veçanta. Gjatë testimit, të marrëveshjeve për shërbime të veçanta dhe pagesave që kanë rezultuar lidhur me to, kemi vërejtur se komuna nuk kishte mbajtur në burim tatin dhe kontributin pensional.</p>		<p>Sherbime të Veçanta dhe te njejtat për tatin në burim dhe kontributet pensionale të punëmarrësve do të deklarohen dhe paguhen me kohë përmes sistemit elektronik te deklarimeve te Administrates Tatimore të Kosovës (EDI Deklarimi).</p>		
<p>Çështja 8 - Mungesa e planit të menaxhimit të kontratave</p> <p>E gjetura: Në pesë dosje të testuara të tenderëve, kemi vërejtur se komuna nuk kishte përgatitur një plan për menaxhimin e kontratave, kërkesë e Ligjit të Prokurimit Publik e përcaktuar me nenin 88 - Aktivitetet e menaxhimit të Kontratave. Mungesa e planit të menaxhimit të kontratave rrit rrezikun e mos monitorimit të aktiviteve të kontraktuara dhe të drejtave tjera të autoritetit kontraktues për tu ushtruar në mënyrë</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se për secilin projekt/Kontratë të lidhur paraprakisht të përgatisë një plan për menaxhimin e kontratave dhe të përcaktojë veprimet që do të merren për të siguruar se për secilin kontratë të nënshkruar ekziston plani për menaxhimin e saj.</p>	<p>Zyra e Prokurimit do te siguroj se do te respektohet LPP në përpikëri dhe zbatimin e kriterëve që dalin nga kërkesat tjera ligjore të kësaj lëmie.</p> <p>Bazuar në LPP Planin per Menagjimin e kontratave do te kerkohet nga Menagjeret e kontratave para fillimit te implementimit te kontratave.</p>	<p>Janar - Dhjetor 2018</p>	<p>Zyra e Prokurimit</p>

efektive.				
<p>Çështja 9 – Pagesa në mungesë të dëshmiave të kontratave për sigurimin fizik të objekteve</p> <p>E gjetura: Sipas kontratës për sigurimin fizik të objekteve komunale, njëri ndër kushtet e kontraktuara ishte angazhimi i 13 të punësuarve nga Operatori Ekonomik (OE) dhe paga e tyre mujore te jetë 200€ neto. Gjatë auditimit të pagesës për muajin shkurt 2017, ne nuk kemi vërejtur se pagesa kishte të bashkangjitur dëshmi nga OE lidhur me numrin e punëtorëve të angazhuar dhe shumën e pagesës mujore, referuar në kushtet e kontratës.</p>	<p>Sipas kontratës për sigurimin fizik të objekteve komunale, njëri ndër kushtet e kontraktuara ishte angazhimi i 13 të punësuarve nga Operatori Ekonomik (OE) dhe paga e tyre mujore te jetë 200€ neto. Gjatë auditimit të pagesës për muajin shkurt 2017, ne nuk kemi vërejtur se pagesa kishte të bashkangjitur dëshmi nga OE lidhur me numrin e punëtorëve të angazhuar dhe shumën e pagesës mujore, referuar në kushtet e kontratës.</p>	<p>Komuna do të ndërmerre hapat e nevojshëm dhe do të shtojë kontrollin nga mbikqyresi i kesaj kontrate se ‘OE’ i perzgjedhur per kryerjen e ketyre sherbimeve po kryen gjitha obligimet tatimore ndaj të angazhuarëve.</p> <p>Administrata Tatimore e Kosovës është obligative para institucionit tone që të vërtetoj se subjektet perfituese te puneve te caktuara nga organet publike, i zbatojnë procedurat conform kontratave te perfituara.</p>	<p>Janar - Dhjetor 2018</p>	<p>Zyra e Prokurimit permes menaxherit te caktuar per kontratën përkatëse.</p>
<p>Çështja 10 – Evidenca të mangëta për pasuritë me vlerë nën 1,000€</p> <p>E gjetura: Sipas rregullores mbi pasurinë jo financiare, pasuria nën 1,000€ dhe stogët duhet të regjistrohen në sistemin E-pasuria.</p>	<p>Kryetari duhet të forcoj kontrollin për siguruar evidentin, menaxhimin dhe raportimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Në këtë aspekt duhet të sigurojë se pas</p>	<p>Do të mirren masa që të trajnohen zyrtarët për menaxhim më të mirë të sistemit “e-Pasuria”</p>	<p>Janar - Dhjetor 2018</p>	<p>Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim</p>

<p>Komuna, për pasuritë më vlerë nën 1,000€ në PFV ka shpалosur 31,411€. Nga testimi i blerjeve gjatë vitit 2017, kemi identifikuar se nuk ishin të regjistruar pasuritë jo kapitale të blera në vlerë totale 6,581€.</p>	<p>procesit të inventarizimit gjendja e inventarizuar krahasohet me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, në mënyrë që diferencat e mundshme identifikohen dhe në pas pasqyrohen në regjistrat e pasurive.</p>			
<p>Çështja 11 - Trajtimi i llogarive të arkëtueshme</p> <p>E gjetura: Përkundër rekomandimit të dhënë në vitin paraprak dhe zotimit për zbatimin e tij edhe me tuje komuna nuk ka marrë veprimet e nevojshme për të krijuar mekanizma për të rritur inkasimin e të hyrave të faturuara. Si pasoje të arkëtueshmet edhe me tuje janë shumë të larta, ose në nivel të njëjtë me vitin paraprak. Nga të arkëtueshmet totale, 78% e tyre i takon tatimit në prone.</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmeve për inkasimin e të hyrave të saj, përfshirë edhe të arkëtueshmet e mbetura nga vitet paraprake, fillimisht duke i shfrytëzuar të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të komunës, me pas të shfrytëzoi edhe masat tjera ligjore për të siguruar inkasimin e tyre.</p>	<p>Përmes shfrytëzimit të të gjitha veprimeve të nevojshme në kuadër të komunës, do të ndërmerren masat e nevojshme ligjore për të siguruar inkasimin e tyre, në mënyrë që saldoja e llogarive të arkëtueshme të zvogëlohet.</p> <p>Njëra prej masave më të reja të cilat kanë filluar të ndërmerren me fillim të vitit 2018 janë masat e inicuarra permbarimore.</p>	<p>Janar – Dhjetor 2018</p>	<p>Drejtoria për Ekonomi Financa dhe Zhvillim përmes Zyres Komunale të Tatimit në pronë.</p> <p>Drejtoria e Urbanizmit, Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor</p>
<p>Çështja 12 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti</p>	<p>Kryetari duhet të sigurojë që zbatimin i planit të</p>	<p>Përmes zbatimit të Planit të Veprimit dhe zbatimit</p>	<p>Janar – Dhjetor</p>	<p>Të gjithë mbajtësit e</p>

<p>paraparak dhe viti i mëhershëm</p> <p>E gjetura: Për shkak të menaxhimit të pa mjaftueshëm të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura në herët janë zbatuar. Ne nuk kemi vërejtur se Komuna aplikon masa përgjegjësie për moszbatimin e rekomandimeve.</p>	<p>veprimt, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.</p>	<p>me përpikëri të të gjeturave paraprahe, do të arrihet të përmirësohet sistemi veprues Brenda organizates buxhetore.</p>	<p>2018</p>	<p>buxheteve dhe njësitë tjera organizative.</p>
<p>Çështja 13 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të NJAB-së dhe komiteti i auditimit</p> <p>E gjetura: Menaxhmenti nuk i kishte dhënë rëndësinë e duhur auditimit të brendshëm, nuk kishte përgatitë plane të veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe nuk kishte zbatuar rekomandimet e dhëna nga NJAB. Komiteti i auditimit</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj funksionimin e plotë të KA-së, si dhe t'i kushtoj rëndësinë e duhur aktiviteve të auditimit të brendshëm. Për secilin auditim të bërë nga NJAB-i, duhet të përgatitsin planet e veprimit si dhe të monitorojnë ato deri në zbatimin e plotë të rekomandimeve. Po ashtu KA duhet t'i rishikoj rezultatet e auditimit të brendshëm</p>	<p>Planet e veprimit do të jenë të hartuara edhe për zbatimin e rekomandimeve nga NJAB.</p>	<p>Janar - Dhjetor 2018</p>	<p>Zyra e Kryetarit të Komunes per NJAB.</p>

<p>(KA) gjatë vitit 2017 nuk ka mbajtur asnjë takim, nga shkakun se kryesuesi i komitetit ka dhënë dorëheqje në fund të muajit maj të vitit 2017 dhe kjo pozitë nuk ishte plotësuar deri në muajin dhjetor të vitit 2017.</p>	<p>dhe veprimet e ndërmarrta nga menaxhmenti në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, në mënyrë që devijimet e mundshme të adresohen me kohë.</p>			
<p>Çështja 14 - Dobësi në kontrollin menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut</p> <p>E gjetura: Si pasojë e kontrolleve të pamjaftueshme menaxheriale, një pjesë e konsiderueshme e buxhetit për investime kapitale dhe mallra e shërbime nuk është shpenzuar. Llogaritë e arkëtueshme nuk ishin trajtuar në mënyrën e duhur nga ana e menaxhmentit. Menaxhmenti po ashtu nuk posedon analiza të rregullta periodike për ecuritë buxhetore, nuk rishqyrton planin e prokurimit dhe nuk ka raporte të rregullta të detajuara për aktivitetet operative.</p>	<p>Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.</p>	<p>Përkushtim të veçant do të kushtohet trajtimit të llogarive të arkëtueshme, përcjelljes së ecurisë financiare të aktiviteve tek të gjitha kategoritë ekonomike të shpenzimeve me focus te veçantë të 'KE' mallra e shërbime dhe investime kapitale, rishqyrtim I planit të prokurimit, etj.</p> <p>Ndersa analizat buxhetore ne baza periodike do të përmiresohen ende edhe pse ato nuk kanë munguar edhe në baza ditore, te cilat I kemi siguruar dhe raportuar tek menaxhmenti i lartë permes sistemit te FRRE BALANCT.</p>	<p>Janar - Dhjetor 2018</p>	<p>Të gjithë mbajtësit e buxheteve dhe njësitë tjera organizative.</p>